

2021-2022


# Universiteti POLIS

## Raporti Vjetor



Raport Vjetor i Universitetit POLIS për veprimtarinë e kryer gjatë vitit akademik 2021 – 2022, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërëse të raportimit vjetor dhe afateve për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", i ndryshuar.

<b>Hyrje</b> .....	<b>2</b>
<b>PJESA A</b> .....	<b>3</b>
Kreu A.1. – Realizueshmëria e Planit Strategjik Institucional.....	6
Kreu A.3. – Kërkimi Shkencor .....	7
Kreu A.4. – Infrastruktura .....	8
Kreu A.5. – Programet e Studimit.....	8
Kreu A.6. – Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .....	12
Kreu A.7. – Personeli Akademik .....	16
Kreu A.8. – Studentët dhe Alumni .....	18
Kreu A.9. – Të dhëna statistikore mbi Studentët .....	19
Kreu A. 10. – Vlerësime dhe rekomandime për MAS .....	24
<b>PJESA B</b> .....	<b>24</b>
Kreu B.1. Struktura Organizative.....	24
Kreu B.2. Raporti financiar .....	25
Kreu B.3. Mobiliteti i personelit akademik.....	26
Kreu B.4. Konformiteti me Kodin e Cilësisë.....	27
<b>ANEKSE</b> .....	<b>24</b>
Aneks 1 - Strategjia e zhvillimi .....	24
Aneks 2 - Udhëzues, Masat COVID-19 .....	24
Aneks 3 - Raport, Veprimtaria Kerkimore Shkencore.....	24
Aneks 4 - Broshura e Bibliotekës.....	24
Aneks 5 - Formularët për çdo proces vlerësimi NJBSC.....	24
Aneks 6 - Planet Mësimore 2021-2022.....	24
Aneks 7 - Pyetësor Alumni .....	24
Aneks 8 - Kalendar i aktiviteteve 2021-2022 .....	24
Aneks 9 - Struktura organizative.....	24
Aneks 10 - Vërtetim shlyerja e detyrimeve 2021-2022.....	24
Aneks 11 - Formulari klubeve studentore.....	24
Aneks 12 - Kalendar i miratuar .....	24



## HYRJE

Universiteti POLIS është një institucion i themeluar me vendim të Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 35386 dt. 04.04.2006 dhe është i licensuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 698, dt. 11.10.2006. Në Tetor 2012, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 746 dt. 24.10.2012, i dha POLIS statusin «Universitet».

Që prej themelimit Universiteti POLIS ka përgatitur një raport vjetor të detajuar të aktivitetit të vet për çdo vit akademik dhe e ka depozituar pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe Agjensisë së Akreditimit.

Këto raporte përmbajnë të dhëna përshkrimore dhe statistikore për aspekte të ndryshme të aktivitetit të institucionit sipas kësaj strukture:

### STATUSI DHE VEPRIMTARIA E U\_ POLIS

Statusi

Misioni Vizioni dhe Vlerat e Universitetit

POLIS Struktura organizative dhe

Organigrama

Stafi akademik dhe administrativ

### PROCESI MESIMOR

Programet e Studimit

Fakulteti Arkitekturës dhe Dizajnit

Fakulteti Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit

Urban Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim

### KERKIM SHKENCOR DHE I APLIKUAR

Kërkimi Shkencor dhe i

Aplikuar Marrëdhëniet

Ndërkombëtare

Biblio\_POLIS

Botime POLIS\_Press

### STUDENTET

Lidhja mësim - kërkim

shkencor Alumni & ZMSKK

Senati Studentor i U\_POLIS

### GARANTIMI I CILËSISË

Njësia e Brëndshme e Sigurimit të

Cilësisë Rezultatet e Vlerësimit

Sfida të NJSBC për të ardhmen

### MENAXHIMI I BURIMEVE FINANCIARE

Burimet e

Financimit

Shpenzimet

Projekt Buxheti për Vitin e Ardhshëm

Raporti është hartuar në përputhshmëri të plotë, duke përfshirë gjithë elementët e parashikuar në Udhëzimin e MAS Nr. 5, datë 19.02.2018, i ndryshuar.

Raporti vjetor i vitit akademik 2021 - 2022, pasohet nga shumë raportet të tjera vjetore që Universiteti POLIS, ka përcjellë çdo vit akademik që prej themelimit të tij.

Ky është një tregues domethënës për kulturën e institucionit dhe ndjeshmërisë së tij ndaj të qenit një institucion sa më i hapur, komunikues dhe llogaridhënës ndaj komunitetit të tij dhe institucioneve partnere.

Qëllimi i hartimit të raportit:

1. Të informojë institucionet monitoruese, partnerët, stafin dhe studentët, si dhe publikun e gjerë për misionin e tij dhe përmbushjen e detyrimeve të veta ligjore duke dhënë një pasqyrë sa më të plotë dhe të saktë të institucionit.
2. Të sigurojë transparencë me institucionet monitoruese, partnerët, stafin dhe studentët, si dhe publikun e gjerë në lidhje me veprimtarinë e tij, programet e ofruara, rezultatet e arritura, gjendjen financiare si dhe aspekte të tjera të punës së institucionit.
3. Të forcojë përgjegjshmërinë sociale të institucionit duke ngritur një sistem të qëndrueshëm llogari-dhënie përpara studentëve dhe grupeve të tjera të interesit.

Raporti është miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr.11 datë 15.09.2022 dhe Bordit të Administrimit, Nr.6, datë 16.09.2022.

## PJESA A

### Kreu A.1. – Realizueshmëria e Planit Strategjik Institucional

*Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.*

Universiteti POLIS ka aktualisht në zbatim Strategjinë e Zhvillimit institucional për periudhën 2021 – 2026, për më shumë rreth strategjisë shiko linkun: <http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/19>.

Strategjia është e organizuar në objektiva afatgjatë dhe afatmesëm, të cilët grupohen në aspekte që i përkasin mësimdhënies, kërkimit, marrëdhënies me tregun dhe të diplomuarit, ndërkombëtarizimin, garantimin e cilësisë etj.

Kjo strategji është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e universitetit dhe struktura institucionale është e organizuar në atë mënyrë që ndihmon në përmbushjen e këtyre misioneve dhe objektivave.

Strategjia përcakton objektivat e synuara dhe rezultatet e pritura bazuar në misionin e tij si një institucion privat dhe laik i arsimit të lartë me një natyrë didaktike, shkencore dhe inovative. Për të kontribuar cilësisht në sistemin arsimor POLIS reflekton objektivat e tij strategjikë si në vijim:

- T'u ofrojë studentëve cilësi të lidhshme profesionale në fushat e projektimit, arkitekturës, ndërtimit, planifikimit territorial, mbrojtjes së mjedisit, shkencave kompjuterike me qëllim që të ushtrojë ndikim në përmirësimin e gjendjes aktuale të vendit dhe të rajonit;
- Të pajisë studentët dhe studiuesit me njohuri të specializuara që plotësojnë kërkesat e tregut të punës dhe kërkesën gjithnjë në rritje për aftësi të tilla përmes standardeve bashkëkohore të garantuara, me qëllim përgatitjen e specialistëve të rinj dhe të kualifikuar, të gatshëm për të kontribuar profesionalisht brenda dhe jashtë vendit;
- Të ofrojë studime më të thelluara dhe të e specializuara në nivelin Master në fushat e mësipërme
- Të kryejë aktivitete hulumtuese shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me aktivitetet akademik për programet e studimeve të ofruara në universitet
- Të organizojë dhe ofrojë studime të ciklit të tretë doktorature në fushat e mësipërme.

Në këtë kuptim kapituajt në vijim do raportojnë në mënyrë të detajuar për secilin aspekt, por në një vlerësim të përgjithshëm, konstatohet realizimi i të gjithë objektivave, kjo bazuar në

vlërësimin e brendshëm por dhe atë të jashtëm i cili kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsmi e Lartë (ASCAL).

Gjatë vitit akademik 2021 – 2022, universiteti ka pasur në proces akreditimi periodik në programet:

1. Të ciklit të dytë Master i integruar i shkencave në "Arkitekturë dhe Dizajn Urban";
2. Të ciklit të dytë Master i integruar i shkencave në "Planifikim dhe Menaxhim Urban";
3. Të ciklit të parë Bachelor në "Shkenca Kompjuterike";
4. Të ciklit të parë Bachelor në "Inxhinieri Ndërtimi";

(për më shumë shiko linkun <https://www.universitetipolis.edu.al/akreditimi/>)

Si pasojë e pandemisë COVID-19, Universiteti POLIS, në përfundimin e afatit të Strategjisë së Zhvillimit, ka hartuar një Strategji të re, e cila do të jetë e fokusuar kryesisht në kontekstin e digjitalizimit, kërkimit shkencor si dhe impakte të tjera të cilat një pjesë e tyre doli si pasojë e pandemisë.

Gjithashtu, gjatë vitit akademik Universiteti POLIS morri të gjitha masat e nevojshme, (për të cilat kemi raportur në mënyrë të vazhdueshme pranë MAS), për zhvillimin e mësimdhënies dhe mbylljen e vitit akademik brenda afatit të parashikuar në kalendarin e tij akademik. Për më shumë shiko (Aneks 12 –Kalendari i miratuar).

## Kreu A.2. – Ndërkombëtarizimi (Projekte dhe Partneritete)

*Informacion mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.*

Gjatë vitit akademik 2021-2022, Universiteti POLIS ka vazhduar me sukses përfshirjen në projekte të financuar nga BE, projekte të bashkëpunimit dypalësh apo instrumentë të tjerë financimi.

### Open Minds- Cooperation Partnership in Youth

Projekti është shpallur fitues gjatë vitit 2021, nga Agjencia Kombëtare Erasmus në Suedi, dhe menjëherë më pas është realizuar takimi i parë i partnerëve të projektit dhe drejtuesve të Agjencisë. Gjatë muajit qershor të 2022, u mbajt takimi menaxherial dhe u prezantua projekti dhe në kuadër të nismës New Bauhuas Europe. Projekti ka në qëndër gjithëpërfshirjen e studentëve në aktivitete kreative, nëpërmjet organizimit të një sërë aktiviteteve në formë "statelitore" dhe fizikisht. Projekti përfundon në vitin 2024.

### Spatial Proposals for the post pandemic city: The case of Lezha (National funds/ AKKSHI).

Projekt kërkimor i financuar nga fondet kombëtare dhe që ka filluar me implementim në tetor të vitit 2021. Projekti ka në qëndër studimin e qyteteve postpandemike dhe si rast studimor është marrë Lezha dhe një set instrumentash për qëndrueshmërinë e qytetit. Në projekt janë angazhuar staf akademik/ kërkues me eksperiencë dhe staf i ri kërkuesish (studentë të doktoraturës).

### Nga 15 janar 2020 ka filluar implementimi i Projektit Erasmus+ CBHE "Developing and Improving Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo/ DRIVE" 610307-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP, për më shumë shiko

<https://driveproject-eu.com/> Objektivi kryesor i projektit është ngritja e kapaciteteve për kërkim dhe inovacion në Universitetet e Shqipërisë dhe të Kosovës si dhe ngritja apo përmirësimi i strukturave të dedikuara për kërkim dhe inovacion. Projekti koordinohet nga Universiteti POLIS, ndërsa Universitete të tjera nga Shqipëria janë: Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti European i Tiranës. Nga Kosova, janë pjesë e Konsorciumit Universiteti i Prishtinës "Hasan

Prishtina”, Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” dhe Kolegji Universum. Gjithashtu pjesë e projektit janë dhe 3 Universitete nga vëndet e Bashkimit Europian, Universiteti Politeknik i Milanos, Universiteti Aalborg dhe Universiteti Politeknik i Hamburgut. Kohëzgjatja e Projektit është tre vjet.

- ✚ Universiteti POLIS, është gjithashtu partner në projektin Erasmus + CBHE **“Accelerating Western Balkans University Modernization by Incorporating Virtual Technologies/ VTech@UniWB”** 610281-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP, <https://vtech-project.eu/> Projekti koordinohet nga Universiteti Aleksandër Moisiu në Durrës. Objektivi kryesor i projektit është implementimi i teknologjive virtuale në mësimdhënie në Universitetet e Shqipërisë dhe Kosovës, dhe ngritja e kapaciteteve të stafit akademik për këtë qëllim. Kohëzgjatja e Projektit është tre vjet.
- ✚ Në janar të vitit 2020, Universiteti POLIS është partner edhe në projektin: **“YES – Youth Employment Skill set in Posting** (Call for Proposals ref. No. VP/2019/008; Grant Agreement Ref. No VS/2019/0395)”, i cili koordinohet nga Commissione Nazionale Paritetica per le Casse Edili (CNCE) dhe ka si objektiv studimin e tregut të punëtorëve në lëvizje në fushën e ndërtimit. Projekti është mbyllur në mars të 2022.
- ✚ Në shkurt të vitit 2020, Universiteti POLIS ka fituar projektin në kuadër të Innovation Challenge për ngritje të FabLab, një strukturë që do të mbështesë Start Up në Shqipëri dhe rajon, që nga faza e idejimit, prototipizimit dhe daljes në treg.
- ✚ Gjatë vitit akademik 2021-2022, u permbyll projekti **Graduates Advancement and Development of University capacities in Albania/GRADUA** për më shumë shiko <https://www.graduaproject.com/gradua-project/> Në qendër të këtij projekti është ngritja e një platforme për studentët e diplomuar për t’ju ardhur në ndihmë për t’u integruar në tregun e punës.
- ✚ Vazhdon projekti: Studimi dhe eksperimentimi i sistemeve ndërtimore për projektimin e godinave me zero energji (ZEB -Zero Energy Building). Projekti është financuar në kuadër të thirrjeve të AKSHI-t, për bashkëpunimin dypalësh Shqipëri- Itali, ndërsa Universiteti POLIS është sëbashku me Institutin e Teknologjisë së Ndërtimit të Godinave (ITC), në Milano.
- ✚ Në kuadër të projekteve për bashkëpunime bilaterale Shqipëri- Austri, Universiteti POLIS vazhdon punën dhe me implementimin e dy projekteve: “Sustainable Urban Development of the Peripheries betëeen Graz and Tirana, Spraeil vs Density” me Universitetin e Grazit, Austri, si dhe “The re-use of existing structures in Austria and Albania” me Universitetin FH Joanneum.
- ✚ Në vitin 2021, Universiteti POLIS ka filluar zbatimin e projektit **“Inclusive tertiary Education in the West Balkans/ IDEA”** 618859-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP, në të cilin ka rolin e Koordinatorit

Universiteti POLIS është në rolin e partnerit në projektin **“Strengthening university autonomy and increasing accountability and transparency of Western Balkans Universities/ STAND”** 618805-EPP-1-2020-1-XK-EPPKA2-CBHE-SP, dhe projekti koordinohet nga International Business College Mitrovica.

**a) Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.**

Mobilitetet e stafit akademik dhe administrative janë realizuar si pjesë e Komponentit të dedikuar për mobilitete pra instrumentit KA1, por edhe në kuadër të trajnimeve si pjesë e implementimit të projekteve në kuadër të programit KA2 CBHE.

Projekti	Staff akademik	Staff Administrativ	Vendi
DRIVE	4	-	Hamburg

DRIVE	1	-	Prishtine
Vtech	1	-	Prishtinë
Vtech	2	-	Lodz, Poloni
Vtech	3	-	Ljubljane, Slloveni
Vtech	1	2	Tartu, Estoni
STAND	1	-	Tetove
STAND	2	-	Foggia, Itali
IDEA	4		Brno, Ceki
IDEA	4		Limerick, Irlandë
IDEA		2	Podgorice, Mal i Zi
IDEA	2		Podgorice, Mal i Zi
Open Mind	1	1	Bruksel, Belgjike

Tabela 1. Të dhëna për mobilitetin e stafit

### Mobiliteti i studentëve

Dhënia e mundësisë që studentët të jenë pjesë e mobiliteteve dhe të realizojnë një periudhë studimi (një semestër) në Universitetet evropiane, është një tjetër prioritet i Universitetit POLIS. Ndonëse Shqipëria është pjesë e kësaj skeme nga viti akademik 2015-2016, vitet e fundit, shifrat e mobilitetit të studentëve flasin për një zhvillim në rritje. Gjatë vitit akademik 2021-2022, lëvizja e studentëve është si më poshtë :

University	Outgoing students
University of Anhalt	19
University of Napoli	1
Politecnico di Bari	3
Ecole School Paris	2
IGS Paris	2
University of Cordoba, Spain	1
Royal Academy of Arts	1
University of West Attica	5
University of Minho	1
FH Joanneum	3
University of Molise	6

Tabela 2. Të dhëna për mobilitetin e studentëve

### Kreu A.3. – Kërkimi Shkencor

Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin: politikat e kërkimit shkencor, të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien, produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;

Konsolidimi dhe përparimi i kërkimit shkencor bazuar në metodat bashkëkohore dhe inovative është një nga objektivat kryesore të U\_POLIS. POLIS dhe partnerët ndërkombëtarë

akademikë/kërkimorë me të cilët janë zyrtarizuar marrëdhëniet përmes marrëveshjeve të njohura nga autoritetet në vendet përkatëse, kanë gjithë kapacitetin njerëzor, financiar, infrastrukturor për të kryer një kërkim shkencor elitari, i mundësuar përveç burimeve të brendshme edhe nga projektet e përbashkëta të financuara nga Qeveritë Amerikane, Italiane, Holandeze dhe Austriake, goftë drejtpërdrejt me U\_POLIS apo edhe me Co-PLAN dhe MetroPolis.

Vetë kërkimi shkencor dhe, sidomos programi i doktoratës përmbledh kapacitetet më të mira akademike dhe kërkimore të U\_POLIS dhe të partnerëve në zbatimin e kësaj doktrature. Partneri strategjik, Universiteti i Ferrarës, Itali, ka shkollën e arkitekturës, të cilësuar prej disa vitesh si nr. 1 në klasifikimet e autoriteteve arsimore-kërkimore në Itali. Programi i Doktoraturës për vitet 2020 -2021 dhe 2021-2022 i ka dhënë dhe do i japë kërkimit dhe inovacionit zgjerim të ri të stafit akademik në të tre Fakultetet duke aktivizuar dhe studentët ekselentë dhe cilësorë. Zhvillimi i ri në zgjerimin e Laboratoreve kërkimore shkencor është një arritje për realizimet e Diplomave në Mastera shkencorë, PHD dhe Post Doktoratura.

Një nga pjesët më të rëndësishme të strategjisë së zhvillimit është edhe Axhenda e Kërkimit Shkencor (*Aneks 3 – Raport, Veprimtaria e Kërkimit Shkencor*). Axhenda Kërkimore e Universitetit POLIS, hartohet me kujdes dhe seriozitet nga autoritet dhe organet drejtuese, në fillim të çdo viti akademik. Një dokument i prodhuar si rezultat i një sesioni reflektimi (*brainstorming*) me pjesëmarrjen e të gjithë stafit akademik. Në mënyrë të përmbledhur, objektivat e Axhendës Kërkimore janë tri:

**Së pari**, Axhenda Kërkimore është një instrument për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, si dhe shërben për të diskutuar prioritetet kërkimore në funksion të misionit dhe strategjisë së U\_POLIS.

**Së dyti**, ajo është një bazë për menaxhimin e kërkimit: ku diskutohen dhe vendosen prioritetet kërkimore, si dhe zhvillohen shumë ide dhe vizione kërkimore, të cilat duhet të ndërmerren. Nëpërmjet kësaj Axhende Kërkimore, POLIS hedh një vështrim më nga afër mbi infrastrukturën kërkimore, stafin dhe çështjet kërkimore të tyre, publikimet si dhe monitoron progresin e zbatimit të kësaj axhende.

**Së treti**, nëpërmjet axhendës kërkimore bëhet e mundur ndjekja e lidhjes midis kërkimit dhe mësimdhënies sepse kërkimi në U\_POLIS duhet të jetë i lidhur me zhvillimin e mësimdhënies në të tre fakultetet. Kërkimi duhet të ushqejë mësimdhënien dhe anasjelltas, gjatë procesit të arsimit duhet të dalin pyetje për kërkimin në mënyrë që kërkimi i realizuar të jetë sa më efikas. Për më tepër objektivi i U\_POLIS është që të luajë një rol më të rëndësishëm në komunitetin e kërkimit ndërkombëtar, duke marrë pjesë në kërkime dhe botime të përbashkëta ndërkombëtare me institucione të tjera.

Konferencat, simpoziumet, kongreset kombëtare e ndërkombëtare si dhe gjithë aktivitetet e tjera akademike, shkencore dhe sociale të zhvilluara gjatë vitit akademik 2021 -2022 janë paraqitur në (*Aneks 3 – Raport, Veprimtaria Kërkimore Shkencore*)

## Kreu A.4. – Infrastruktura

*Infrastruktura, të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor*

Biblioteka e U\_POLIS ka një fond aktual prej 10, 400 titujsh në përputhje me programet që ofron duke qënë kështu një bibliotekë shumë e pasur për këto disiplina. Biblioteka ka literaturë të mjaftueshme dhe të shumëllojshme e cila i vjen në ndihmë studentëve që dëshirojnë të përdorin këto burime për realizimin e projekteve, kërkimeve shkencore dhe përgatitjen e tezave U\_POLIS.

Në bibliotekë si rrjedhojë e shumëllojshmërisë që ofron janë përfshirë periudike të ndryshëm të shkruar dhe elektronikë të revistave më influencuese shkencore të momentin.



Gjatë vitit akademik 2021 – 2022 Universiteti POLIS, vazhdon abonimin në dy nga bibliotekat më të larmishme ndërkombëtare online **EBSCO dhe JSTOR e-library**. Ky hap kaq i rëndësishëm përkoji dhe ndikoi pozitivisht për studentët në një periudhë të vështirë si kjo që kemi kaluar gjatë periudhës së shkaktuar nga pandemia COVID – 19. Prezenca e kufizuar në auditore pati shumë pasoja për studentët një nga të cilat ishte dhe pamundësia e frekuentimit të bibliotekës. Fatmirësisht masat e marra nga Universiteti POLIS, bënë të mundur që studentët dhe jo vetëm por cdo anëtar i komunitetit POLIS, të ketë akses dhe të mund të përdori këto dy *e-library* (të pasura me literaturë të kategorive të ndryshme ndërkombëtare) për të thelluar njohuritë dhe dijet në fushat e tyre të interesit.

Synohet pasurimi i vazhdueshëm i Bibliotekës nëpërmjet blerjeve, donacioneve nga partnerë (i.e UNIFE) dhe botimeve të stafit të U\_POLIS (*Aneks 4- Broshura e Bibliotekës*).

Një objektiv tjetër shumë i rëndësishëm strategjik i POLIS është ai i fuqizimit të laboratorëve përzhvillimin e veprimtarive cilësore. U\_POLIS aktualisht ka 7 laboratorë të shfrytëzueshëm për qëllime didaktike dhe kërkimore:

1. Laboratori i Mjedisit
2. Laboratori i GIS/CAD/SAP/ETABS/TEKLA
3. Laboratori i MAC
4. Laboratori i Eficiencës Energjitike
5. Laboratori i Prototipizimit
6. Laboratori i Shkencave Kompjuterike
7. Laboratori Innovation Factory
8. Laboratori i Modelimit
9. Laboratori Fab Lab
10. Laboratori PC Lab

Një pjesë e laboratorëve janë të akredituar dhe janë për shërbim ndaj të tretëve.

Ndërsa përsa i përket një informacioni më të detajuar me të dhëna specifike për pajisjet laboratorike është raportuar nëpërmjet plotësimit të përvitshëm të raporteve të posaçme të kërkuara nga MAS si *"Formulari i Vlerësimit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor"* dhe kapacitetet pritëse. Sa më sipër kanë qënë dhe subjekt i verifikimit fizik gjatë vizitës së përvitshme për verifikimin e kapaciteve pritëse.


## Kreu A.5. – Programet e Studimit

*Të dhëna mbi programet e studimit, IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar. IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit*

*të studimit që është në process vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillimin profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.*



Programi i studimit	Baza ligjore		Statusi	Akreditimi
	Vendimi i Këshillit të Ministrave	Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve		Urdhri i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve
<b>Fakulteti i Arkitekturës dhe Dezajnit</b>				
<b>Master i Shkencave në Arkitekturë dhe Dizajn Urban 5 vjet Full-Time (300 ECTS)</b>	Nr. 698, datë 11.10.2006	Nr. 102, datë 24.04.2009	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009 Akreditim Periodik : Urdhër Nr. 268, datë 20.05.2016  Ka përfunduar procesi i akreditimit, jemi në pritje të vendimit të bordit për vlerësimin përfundimtar.
<b>Bachelor në Art Dizajn 3 vjet Full-time (180 ECTS)</b>	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr. 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013  Riakredituar me Vendim Nr. 1, dt. 01.02.2019
<b>Master Shkencor në Dizajn të Aplikuar. 2 vjet Full-time (120 ECTS)</b>	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr. 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013  Riakredituar me Vendim Nr. 3, dt. 01.02.2019
<b>Mastera Profesional 2 vjet Part-Time (90 ECTS) me tre profile në:</b>	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr. 587 datë 20.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013  Riakredituar me Vendim Nr. 2, dt. 01.02.2019
<b>Dezajn Parametrik në Arkitekturë</b>		Riorganizuar: Urdher Nr. 588 datë 20.12.2010 (MND)		
<b>Dezajn Strukturore-Eстетik</b>		Riorganizuar: Urdhër Nr. 431 datë 11.11.2015		
<b>Dezajn Urban-Peisazh</b>		Riorganizuar: Urdhër nr. 438 date 12.11.2015 (i korigjuar)		
<b>Master Profesional në Arkitekturë Dixhitale 1.5 (një vit e gjysmë) më kohë të zgjatur (60 ECTS)</b>		Riorganizuar: Urdher nr. 465 date 03.12.2015 (i korigjuar)		
		Riorganizuar: Urdhër Nr. 377		

		datë 23.09.2021		
<b>Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi 3 vjet Full-time (180 ECTS)</b>		Nr. 315, datë 21.07.2014	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr.270, dt.20.05.2016  Ka përfunduar procesi i akreditimit, jemi në pritje të vendimit të bordit për vlerësimin përfundimtar.
<b>Bachelor në Arkitekturë - Urbanistikë 4 vjet Full-time</b>	VKM Nr. 698, datë 11.10.2006	Urdhër riorganizimi Nr. 102, datë 24.04.2009	Pezulluar	
<b>Master Shkencor në Inxhinieri Ndërtimi me dy profile a) Strukturë b) Gjeoteknikë 2 vjet Full-time (120 ECTS)</b>		Urdhër Nr. 432 datë 12.11.2015	Aktive	Akredituar me Vendim Nr. 12, datë 30.03.2018
<b>Fakulteti i Planifikimit, Mjedisit dhe Menaxhimit Urban</b>				
<b>Master Shkencor në Planifikim dhe Menaxhim Urban 5 vjet Full-time (300 ECTS)</b>	Nr. 698, date 11.10.2006	Nr. 102, datë 24.04.2009	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 227, datë 22.07.2009  Akreditim periodik: Urdhër Nr.266, dt.20.05.2016  Ka përfunduar procesi i akreditimit, jemi në pritje të vendimit të bordit për vlerësimin përfundimtar.
<b>Bachelor në Studime Mjedisore 3 vjet me kohë të plotë (180 ECTS)</b>	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013  Riakredituar me Vendim Nr. 4, dt. 01.02.2019
<b>Bachelor në Administrim Biznes 3 vjet me kohë të plotë (180 ECTS)</b>		Nr. 429, datë 18.07.2022	Do të aktivizohet në vitin akademik 2022-2023	
<b>Master Shkencor në Menaxhim Mjedisor Urban 2 vjet me kohë të plotë (120 ECTS)</b>	Nr. 406, datë 26.05.2010	Nr 557, datë 09.12.2010	Aktive	Akredituar me Urdhër Nr. 250, datë 14.06.2013  Riakredituar me Vendim Nr. 6, dt. 01.02.2019

<b>Mastera profesionale 2 vjet Part-time (90 ECTS) me tre profile ne:</b>		Urdher Nr.587, date 20.12.2010		
<b>Planifikim Hapësinor dhe Aplikime GIS</b>		Riorganizuar: Urdher Nr.588 date 20.12.2010 (MND)		
<b>Strehim dhe Zhvillim Toke</b>		Riorganizuar: Urdher nr. 431 date 11.11.2015		Akredituar me Urdher Nr. 250, date 14.06.2013
<b>Zhvillim Social Urban dhe Burime Njerëzore</b>	Nr. 406, date 26.05.2010	Riorganizuar: Urdher Nr. 438 date 12.11.2015 (i korigjuar)	Aktive	Riakredituar me Vendim Nr. 5, dt. 01.02.2019
<b>Master Profesional në Planifikim Teritori dhe GIS 1.5 (një vit e gjysmë) me kohë të zgjatur (60 ECTS)</b>		Riorganizuar: Urdher Nr. 465 date 03.12.2015 (i korigjuar)		
		Riorganizuar: Urdher Nr. 376 date 23.09.2021		
<b>Master Profesional në Administrim Biznes 2 vite Part-time (90 ECTS)</b>		Nr. 336, date 16.08.2013		Akreditim periodik: Urdher Nr.269, dt.20.05.2016
<b>Master Shkencor në Administrim Biznes 2 vite me kohë të zgjatur (120 ECTS)</b>		Riorganizuar: Urdher Nr. 378 date 23.09.2021	Aktive	
<b>Bachelor në Planifikim Urban 4 vjet Full-time</b>	VKM Nr. 698, date 11.10.2006	Riorganizuar me Urdher Nr. 102, date 24.04.2009	Pezulluar	
<b>Fakulteti për Kërkim dhe Zhvillim</b>				
<b>PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban</b>		Nr. 563, date 19.11.2012	Aktive	Akredituar me Urdher Nr. 187, date 15.05.2015  Ka përfunduar procesi akreditimit dhe pritët Vendimi i Bordit
<b>Bachelor në Shkenca Kompjuterike 3 vjet Full-time (180 ECTS)</b>		Urdher nr. 815, date 21.12.2018	Aktive	Ka përfunduar procesi i akreditimit dhe pritët Vendimi i Bordit.
<b>Program Profesional në Mirëmbajtje Rrjete Kompjuterike 2 vite Full-time (120 ECTS)</b>		Urdher Nr. 814, date 21.12.2018	Aktive	Ka përfunduar proçesi i akredimit, jemi në pritje të vendimit të bordit për vlerësimin përfundimtar.
<b>Program Profesional në Eficencë Energjetike 2 vite Full-time (120 ECTS)</b>	Nr. 533, date 08.05.2014	Nr. 315, date 21.07.2014	Aktive	Akredituar me Urdher Nr. 242, date 17.06.2015  Ka përfunduar proçesi i

				akreditimit, jemi në pritje të vendimit të bordit për vlerësimin përfundimtar
<b>Master Shkencor në Shkenca Kompjuterike 2 vite Full-time (120 ECTS)</b>		Urdhër Nr. 352, datë 17.09.2021	Do të aktivizohet në vitin akademik 2022-2023	
<b>Master Ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore 1 vit Full-time (60 ECTS)</b>		Urdhër Nr. 351, datë 17.09.2021	Do të aktivizohet në vitin akademik 2022-2023	

## Kreu A.6. – Njësia e Brendshme e Sigurimit të cilësisë

### 1. Përbërja e NJBSC për vitin akademik 2021-2022

EMËR MBIEMËR	DETYRA
<b>Manjola Hoxha</b>	<b>Kryetar</b>
Edmond Agolli	Anëtar
Merita Guri	Anëtar
Keti Hoxha	Anëtar
Ermal Hoxha	Anëtar
Anjeza Dajzmaili	Anëtar
Armela Reka	Anëtar (Përfaqësues i studentëve)
Gjergji Dushniku	Anëtar (Përfaqësues i ALUMNI)
Anila Zeqo	Anëtar (Përfaqësues Komuniteti i Biznesit))

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është konceptuar si një njësi e përhershme, e pavarur, e cila nëpërmjet funksionit të saj kryesor, vlerësimit të cilësisë, synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike në mënyrë që të shihet çdo aspekt me syrin e cilësisë, me krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në POLIS. Zhvillimi institucional, rritja e gamës së ofertës akademike të POLIS, si dhe dalja e studentëve të parë në tregun e punës, përbëjnë një sfidë serioze dhe vënë në provë cilësinë e programeve akademike dhe rezultateve të mësimnxënies.

Pavarësisht emërtimeve të njësive ndër vite, qëllimet e NJBSC kanë qenë të njëjta, fokusuar kryesisht në vlerësimin e performancës në procesin mësimor si për stafin akademik ashtu edhe për komponentë të tjerë të lidhur me procesin si bibliografia dhe materialet e studimit, infrastruktura dhe llogjistika.

Disa nga veprimtaritë kryesore të njësive janë si mëposhtë vijon:

- Analiza në përmbajtje të programeve të studimit, pas marrjes së feedback-ut nga studentët, pedagogët, studentët e punësuar dhe tregu i punës.
- Përqasjen ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin në formë dhe përmbajtje të programeve që ofron.

- c) Vlerësimin e aktivitetit kërkimor-shkencor individual dhe institucional si dhe adresimin e përfshirjes së studentëve veçanërisht të cikleve të dyta e të treta të studimit në kërkim konkret bashkëkohor.
- d) Vlerësimin shumëdimensional të stafit mësimdhënës e mbështetës mbi bazën e treguesve të qartë, specifike e të njohur.
- e) Vlerësimin në funksion të qëllimit, të faciliteteve burimeve material, logjistikës dhe shërbimeve të tjera ndaj studentëve e komunitetit në përgjithësi, në funksion të programeve të studimit, strategjisë institucionale e objektivave të formimit.
- f) Vlerësimin e financimit dhe burimeve njerëzore në funksion të proceseve kryesore mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe asistimit të studentëve sipas kërkesave e nevojave bashkëkohore të jetës akademike e punësimit.
- g) Fokusim në dhe vlerësimin e dimensionit kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit, bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ofertën akademike të përbashkët në nivel rajonal e ndërkombëtar si dhe marrëdhëniet me publikun në përgjithësi.
- h) Vlerësimin e hapjes së marrëdhënieve të institucionit me tregun e punës, lokal, kombëtar rajonal e më gjerë për identifikimin, rritjen e mundësive dhe të cilësisë së punësimit të studentëve të të gjitha niveleve e programve të studimit.
- i) Vlerësimin e efektshmërisë dhe përputhshmërisë së zhvillimeve në planin institucional, akademik e kërkimor me qëllimet, synimet e objektivat zhvillimore të U\_POLIS.
- j) Vlerësimi i aspekteve akademike, kërkimore, administrative, menaxheriale mbi bazën e treguesve të përgjithshëm dhe specifike (Tregues të përgjithshëm dhe të veçantë të Performancës), të cilët aktualisht janë në procesin përgatitor.

Në këtë kuadër një prej detyrave më të rëndësishme të NJBSC, ku tashmë njësia ka fituar dhe një fare ekspertize, është dhe procesi i vlerësimit të cilësië dhe performancës së stafit akademik në procesin mësimor. Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi: nga studentët, kolegët, vetvlerësimi (vetvetja) dhe nga eprori/ët.

*(1) Vlerësimi nga studentët (pesha në vlerësimin total është 50%)*

Universiteti POLIS në filozofinë e vet, studentin e ka pasur gjithnjë në qendër të vëmendjes, duke e parë atë jo vetëm si student, por dhe si bashkëpunëtor në këtë rrugë të gjatë të ngritjes dhe përmirësimit të institucionit. Në përfundim të cdo semestri akademik marrja e mendimeve të studentëve mbi cdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë, pedagog apo mbi një problem specifik (Aneks 24, Formulari për performancën administrative të institucionit) nëpërmjet pyetësorëve kanë ndikuar drejtëprdrejtë në sigurimin e cilësisë në këtë institucion. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit, ku, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik. Përmbajtja e pyetësorëve është standarte dhe konsiston me një interval vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri te 5 (maksimumi i vlerësimit). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe plotësohet në mënyrë elektronike.

*(2) Vlerësimi nga kolegët (pesha në vlerësimin total është 35 %)*

Ky proces që ndryshe është emërtuar (vlerësim nga të barabartët) kryhet nëpërmjet ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët. Për realizimin sa me korrekt dhe në kohë njësia ka hartuar një kalendar, nëpërmjet të cilit përcaktohen afatet kohore se kur duhet të përfundojë vlerësimi në fjalë.

*(3) Vetë-vlerësimi (pesha në vlerësimin total është 15%)*

Vetëvlerësimi i pedagogëve është gjykuar si një komponent që dëshmon për shkallën e njohjes që vetë pedagogët kanë për cilësinë dhe kulturën e cilësisë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual.

*(4) Vlerësim nga drejtuesit*


Vlerësimi i katërt është vlerësimi që realizohet përmes një procesi analize dhe feedback të kombinuar edhe me analizat semestrale. Gjithashtu vlerësimi që kryhet nga drejtuesit përmes ballafaqimeve e bisedave informale e plotëson kuadrin e vlerësimit nga këndvështrimi i pritshmërive të drejtuesve dhe kërkesave që kanë për cilësinë e aktivitetit akademik. Me stafin e ri ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillim, orientim, njohjen me praktikën më të mira me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik. Ky vlerësim shërben si vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik përfshi edhe

punën shkencore dhe bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit.

## 2. Procesi i vlerësimit akademik ne nivel Universiteti


Për vlerësimin e mësidhënies sipas sistemit 360°, kryerja e këtij procesi bëhet tërësisht online nëpërmjet portalit të posaçëm dedikuar këtij procesi në sistemin elektronik PITAGORA të Universitetit POLIS, gjë që e bën jo vetëm më eficient, më të menaxhueshëm dhe më objektiv. Kryerja e procesit online garanton vlerësimin në masën 100 % duke gjeneruar raporte më të sakta dhe në një kohë shumë më të shkurtër për tu përdorur nga drejtuesit e njësive në komunikimin e tyre me stafin akademik.

Vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies, gjatë vitit akademik 2021-2022 janë bërë online, nëpërmjet platformës PITAGORA. Si më poshtë jepen të dhëna për % e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor. Këto të dhëna janë në nivel institucional duke patur mundësi krahasimi semestri i parë me atë të dytë.



**Grafiku 1.** Pjesëmarrja e studenteve ne pyetësor per secilin program studimi

Si poshte jepen te dhena per pjesemarrjen e studenteve ne pyetësor por bazuar sipas programeve perkatese.




**Grafiku 2.** Pjesemarrja e studenteve ne pyetesor per secilin program studimi

### 3. Krahasimi i vlerësimit të pedagogëve në nivel fakultetesh/semestri parë

Në tabelën e mëposhtme, mund të shikohet vlerësimi që ka marrë stafi për çdo semestër në intervalin 1-5.

#### Semestri i I


Bazuar në tabelën e mëposhtme, vihet re se vlerësimi më i ulët i stafit për semestrin e parë është 3.5 pikë.



**Grafiku 1.** Vlerësimi pikë-përqindje e stafit akademik në nivel universiteti

#### Semestri i II

Bazuar në tabelën e mëposhtme, vihet re se vlerësimi më i ulët i stafit për semestrin e dytë është 3 pikë.




**Grafiku 2.** Vlerësimi pikë-përqindje e stafit akademik në nivel universiteti

Krahasimi i vlerësimit të stafit Semestri i I dhe Semestri i II, për të treja njësitet kryesore.







## PËRFUNDIME

Nga rezultatet e vlerësimeve të studentëve të Universitetit Polis për pedagogët dhe procesin mësimorë, nëpërmjet platformës PITAGORA. Në përfundim të procesit rezultoi se stafi akademik i U\_POLIS ka pasur një angazhim dhe përkushtim serioz në procesin e mësimdhënies online dhe të integruar duke arritur rezultate pozitive në vlerësimin procesit mësimor.

Të gjitha këto të dhëna vendosen në dispozicion të fakulteteve përkatëse me qëllimin përmirësimin dhe krijimin e proceseve për bashkëkohore të mësimdhënies.

## Kreu A.7. – Personeli Akademik

*Parashikimin për angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t, dhe/ose moduln/et që do të zhvillojë secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik 2021-2022.*

Parashikimi i stafit akademik, lëndët e zhvilluara nga secili prej tyre dhe ngarkesa respektive përcaktohen në planet mësimore për secilin program studimi, hartuar nga Departamentet përgjegjëse dhe miratuar nga Senati Akademik.

Për vitin akademik 2021-2022, bashkëlidhur planet mësimore për të gjitha programet e studimit të U\_POLIS janë përfshirë në *(Aneksin 6 - Planet Mësimore 2021-2022)*.

## Kreu A.8. – Studentët dhe Alumni

*Të dhëna për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që IAL-të ofrojnë, të shoqëruar me burimin e informacionit dhe adresën ku konfirmohet informacioni, duke specifikuar: përqindjen e punësimit të të diplomuarve, nëse institucioni deklaron se programet e ofruara përgatisin për një karrierë apo profesion të caktuar; përqindjen e të diplomuarve që kalojnë provimin e shtetit dhe licensohen, kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar.*

Universiteti POLIS ka një njësi të posaçme e te pavarur për mbështetjen e studentëve e cila është emërtuar Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës<sup>1</sup>, (<https://www.universitetipolis.edu.al/karriera-studentore-eventet/>).

<sup>1</sup> Zyra e Mbështetjes dhe Këshillimit të Karrierës tani e tutje do të përmendet me shkurtimin: ZMSKK

Kjo njësi kryen funksion të dyfishtë. Së pari duke asistuar studentët gjatë kohës së ndjekjes së studimeve me anë të mbështetjes në jetën sociale studentore në POLIS, me aktivitetet kulturore, sportive e artistike vjetore në bashkëpunim me Senatën Studentor.

Së dyti, duke ndërmjetësuar hapësira për praktika profesionale dhe punësim. Këtë proces, ZMSKK e realizon duke mbajtur komunikime të vazhdueshme me biznese, kompani e institucione të ndryshme, duke realizuar marrëveshje bashkëpunimi, panairë karriere etj.

Kjo njësi, ka krijuar një database që prej daljes së brezave të parë në tregun e punës dhe mban kontakte periodike me studentët duke përditësuar njëkohësisht këtë database.

ZMSKK njek ecurinë profesionale të të diplomuarve, duke gjurmuar punësimin e tyre, arritjet, vështirësitë dhe përshtatjen me tregun e punës. Këto procese, kjo njësi i ndjek edhe në bashkëpunim me Shoqatën ALUMNI, (ish-studentëve të Universitetit) dhe shoqatën AUA (Unioni i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbanë); nëpërmjet të cilave mundëson njohjen e dinamikave të tregut të punës, proceset e lobimit dhe mbrojtjes së të drejtave profesionale, si dhe procedurat e provimeve të shtetit apo liçensimit.

Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni që kjo zyrë synon fillon që me azhurnimin e kontakteve të Alumni, të cilat shërbejnë për komunikim më të drejtpërdrejtë me ta. Ky proces, duke filluar që nga muaji Qershor i vitit 2019, është lehtësuar pjesërisht nga implementimi i platformës Gradua (<https://gradua.rash.al/>); projekt i mbështetur nga BE ku U\_POLIS bën pjesë dhe konsiston në integrimin e studentëve drejt mbylljes së studimeve në një hapësirë gjithëpërfshirëse me bizneset, për të qenë më pranë tregut të punës.

Në këtë platformë Alumni përditësojnë faqen e tyre personale me formimin akademik, eksperiencat profesionale dhe studimet e mëtejshme. Ky informacion ka një përfitim të dyfishtë pasi ndihmon ish-studentët të kenë më shumë akses në hapësirat e punësimit, por ndërkohë ndihmon edhe ZMSKK me përthithjen e një pjese të informacionit që kjo njësi synon të akumulojë dhe elaborojë gjatë vitit akademik për të ndjekur ecurinë profesionale të të diplomuarve ndër vite.

Më tej, ZMSKK përmbledh informacion për studime të mëtejshme, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup. Për më tepër kjo njësi bashkëpunon ngushtë edhe me drejtuesit e Shoqatës Studentore POLIS, nëpërmjet të cilëve është arritur krijimi i një marrëdhënie të ngushtë dhe të për bashkëpunuese për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimeve të ofruara nga universiteti për studentët.

Veprimtaritë dhe detyrat kryesore të Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës janë:

- ✓ Informimi i studentëve dhe sigurimi i transparencës së plotë për çështjet e aspektet akademike, mësimore dhe shkencore si dhe me të drejtat e detyrat e tyre;
- ✓ Orientimi i studentëve në shkollimin dhe gjatë shkollimit për zgjedhjen e fushave formuese specifike dhe mundësive të formimit që ofron universiteti;
- ✓ Orientimi dhe njohja e studentëve me tregun e punës në përgjithësi dhe mundësitë e veçanta e të momentit për punësimin duke ndërmjetësuar këtë proces;
- ✓ Të mbajë kontakte individuale me studentët edhe pas diplomimit e punësimit të tyre duke marrë në mënyrë të vazhduar feedback-un e tyre;
- ✓ Të kryejë studime të përditësuara të tregut të punës dhe identifikimin e kërkesave të tij dhe t'i vëre ato në dispozicion të studentëve;
- ✓ Rregullon dhe siguron përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, në proceset e aktivitetet kryesore që lidhen me mësimdhënien dhe aktivitetet e tjera kërkimore e zhvilluese si dhe shërbimet që u ofrohen;
- ✓ Trainim për mënyra aplikimi në institucione të ndryshme dhe përgatitje të dokumentacionit aplikues, etj.

Përsa i përket informacionit që ZMSKK akumulon, duke filluar nga muaji Korrik e deri në muajin Shtator, i referohet informacionit të vetë-deklaruar të studentëve të diplomuar, mbledhur nëpërmjet një pyetësi që ZMSKK përdor për gjenerimin e informacionit nga ALUMNI, (*Aneksin 7–Pyetësor Alumni*). Të diplomuarit deri në mbyllje të vitit akademik 2021-2022, gjatë kësaj periudhe

të mbledhjes së të dhënave janë përgjigjur pyetësorëve në masën 90.9%, cila në shifra përkthehet në raportin: 1629 / 1792 studentë.

Nga kjo popullatë e cila ka plotësuar me sukses pyetësorin, 94.47% e tyre deklarojnë që janë të punësuar (1539 studentë). Kjo shifër do të mund të paraqitet me luhatje të vogla, nëse përqindja e përgjigjeve nga studentët do të ishte 100%.

Informacion më të detajuar në lidhje me punësimin, sektorët ku zhvillohet ky punësim dhe nëse studentët e diplomuar ndjekin studime të metejshme aktualisht, gjenden në tabelën me poshtë<sup>2</sup>:

Të dhëna mbi të diplomuarit në mbyllje të vitit akademik 2020-2021												
NR.	Programet e Studimit	Nr. i të diplomuarve deri në vitin 2021-2022	Të punësuar ose jo		Punësimi në lidhje me profesionin e fituar		Sektori i Punësimit		Angazhimi në biznese private / punësim		Studime të metejshme	Pa përgjigje
			Gjithsej të Punësuar	Jo të punësuar	Të punësuar në profesion	Të punësuar jo në profesion	Punësuar në sektorin publik	Punësuar në sektorin privat	Freelancer	Biznese Private	Vazhdojnë Studime	
1	Shkolla Profesionale (Eficence Energjike dhe Mirembajtje Rrjete Kompiuterike)	192	156	8	112	44	9	147	3	8	4	28
2	BSc. Art Dizajn	225	201	12	192	9	8	193	56	18	35	12
3	BSc. Inxhinieri Ndërtimi	102	89	4	81	8	6	83	0	5	27	9
4	BSc. Studime Mjedisore	97	74	12	45	29	11	63	1	4	19	11
5	MSc. Arkitekturë në Urban Dizajn	362	317	16	304	13	31	286	91	47	15	29
6	MSc. Planifikim dhe Menaxhim Urban	122	97	11	86	11	69	28	0	5	9	14
7	MP në Dizajn Parametrik Arkitektonik (FAD)	132	116	3	107	9	25	91	11	8	5	13
8	MP në Politika të Zhvillimit të Territorit dhe MBA (FPMMU)	294	254	11	235	19	35	219	6	7	6	29
9	Master Shkencor (Dizajn i aplikuar, Inxh. Ndërtimi, Menaxhim Urban)	266	235	13	224	11	31	204	14	4	6	18
<b>TOTAL</b>		<b>1792</b>	<b>1539</b>	<b>90</b>	<b>1386</b>	<b>153</b>	<b>225</b>	<b>1314</b>	<b>182</b>	<b>106</b>	<b>126</b>	<b>163</b>

Figura 1: Tabela Përmbledhëse e situatës së punësimit të studentëve të diplomuar deri në mbyllje të vitit akademik 2020-2021


Nga tabela e mësipërme mund të vërejmë që nga numri total i studentëve që i janë përgjigjur pyetësorit (prej 90.9%), 94.47% rezultojnë të punësuar, nga ku 90.05% e tyre deklarojnë të jenë të punësuar në përputhje me profesionin e tyre.

Në bazë të përpunimit statistikor dhe popullatës që është përgjigjur me statusin e të punësuarit, pjesa më e madhe e tyre (85.38%) janë integruar më së shumti në sektorin privat të punësimit dhe vetëm 14.61% në sektorin publik.

Gjithashtu, në bazë të informacionit të akumuluar rezultojnë që: 12.56% aplikojnë profesionin në format individual si freelancer dhe 7.31 % e tyre kanë ngritur dhe bizneset e tyre individuale ose zhvillojnë bizneset familjare.

Në vazhdim të rritjes profesionale, 7.73% e të diplomuarve në POLIS kanë zgjedhur të ndjekin aktualisht një program studimi tjetër<sup>3</sup>, nga të cilët 62.15% i përkasin studentëve që kanë mbyllur Ciklin e parë të studimeve dhe kanë vazhduar studimet menjëherë në ciklin e dytë. Një pjesë më e vogël (37.85%) i referohet studimeve në program të dytë studimi, studime të ciklit të tretë, kurse të formimit të vazhduar etj.

## Broshura Alumni



<sup>2</sup> **Shënim 1:** Për lehtësi në llogaritje, një pjesë e programeve të studimit grupohen sipas ciklit/profillit. Kjo do të thotë që nr. i Programve të paraqitur në tabelë (9) nuk korrespondon me nr. total të Programeve të Studimit që kanë diplomuar studentë deri në këtë vit akademik (14).

**Shënim 2:** Të dhënat e mësipërme i përkasin të diplomuarve deri në vitin mbyllje të vitit akademik 2020-2021 të mbledhura deri në muajin Shtator 2022.

**Shënim 3:** Numri total i të punësuarve nuk është i barabartë me numrin total të të gjithë zërave të tjerë të punësimit, pasi një i diplomuar mund të rezultojë i dypunësuar / i angazhuar në biznes privat.

**Shënim 4:** Llogaritja e përgjigjeve të studentëve në lidhje me sektorin e punësimit përfshin numrin total të përgjigjeve, ndërkohë që në kategorinë e Angazhimit në Inicjativa private janë evidentuar studentët e pozicionuar në sektorin privat, që e gjejnë veten si profesionistë të lirë (freelance) ose si individë që kanë themeluar / janë pjesë e bizneseve private ose familjare.

**Shënim 5:** Në llogaritjet tabelore, studentët e nivelit të tretë (doktoratë), nuk janë marrë në konsideratë, duke qenë se situata e punësimit të tyre është 100% (nga të cilët përafërsisht 95% në institucione të arsimit të lartë) dhe janë një kategori me ecuri akademike dhe profesionale të pavarur.

**Shënim 5:** Në këtë proces nuk janë përfshirë gjithashtu, programet e reja të studimit që nuk kanë diplomuar akoma studentë.

Nga komunikimet me Alumni, por edhe ndjekjes në forma të tjera të karrierës së tyre profesionale, disa nga eksperiencat më domethënëse dhe rrugëtime të tyre, bëhen pjesë e një Broshure të Posaçme, e cila publikohet 1 herë në 2 vite. Kjo përmbledhje bëhet baza për krijimin e formave të tjera të bashkëpunimit mes të diplomuarve dhe studenteve aktuale të POLIS si: biseda të hapura në auditor, tutoriate për tema konkrete, bashkëpunim për workshope të ndryshme, etj. Për shkak të situatës së Pandemisë, publikimi i nr. të rradhës së kësaj broshure është shtyrë me 1.5 vite kalendarik dhe publikohet në fund të vitit 2022.

### ***Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese të IAL-së dhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.***

Studentët janë të organizuar në mënyrë të pavarur në **Senatin Studentor** ku zgjedhin me vullnet të lirë përfaqësuesit e tyre (me të drejtë për ushtrimin e kësaj detyre përgjatë 2 viteve), në proporcion me numrin e studentëve nëpër klasa, përafërsisht 1 përfaqësues për 30-40 studentë. Përfaqësia Studentore për vitin akademik 2020-2021, paraqitet në linkun: (<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/56>)

Studentët përfaqësohen gjithashtu në **Senatin Akademik të Universitetit**, i cili është organi më i lartë drejtues i institucionit, në masën 15.8% (3/19) (<https://www.universitetipolis.edu.al/senati-akademik/>)

Ndërsa në **Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë**; nga 9 anëtarë të NJSBC, 1 është përfaqësues i studentëve aktualë dhe 1 i atyre të diplomuar (Alumni), duke mbuluar 22.2% të antarëve të njësisë (<https://www.universitetipolis.edu.al/struktura-te-pavarura/>).

Brenda Strukturës së Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës, aktualisht gjysma e anëtarëve përfaqësohet nga Alumni të cilët ndjekin së brendshmi mbarëvajtjen dhe problematikat profesionale.

Në Strukturën e POLIS, funksionojnë edhe **Klubet e pavarura** të cilat ndajnë sëbashku filozofinë e Universitetit, mbështetur në vlerat e misionit të universitetit dhe bashkëpunojnë sëbashku për ngritjen e një jete sociale dhe forcimin e komunitetit "Polis-ian". Klubet Studentore ri-organizohen çdo fillim viti akademik, ku studentët me anë të plotësimit të formularit organizohen në klubin përkatës për të zhvilluar interesat e tyre, dhe sëbashku bashkëpunojnë brenda kategorive: Klube Sportive, Artistike dhe Social-Kulturore, për të realizuar aktivitete të ndryshme gjatë vitit! (**Aneks 11. Formulari Klubeve Studentore**).

Aktivitetet e parashikuara për rritjen e frymës së grupit në komunitetin studentor të U\_POLIS janë të parashikuara në çdo fillim viti nëpërmjet një programi vjetor të hartuar nga ZMSKK dhe Komuniteti Studentor. Llojet e aktiviteteve të parashikuara dhe të përgjatë vitit akademik 2021-2022<sup>4</sup> mund t'i shohim në (**Aneks 8 - Kalendarit aktivitetëve 2021-2022**).

## **Kreu A.9. – Të dhëna statistikore mbi Studentët**

Numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe atyre të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit; numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, të përcaktuar në dokumentin e prioritetëve të miratuar dhe të publikuar çdo vit nga ministria sipas drejtimeve kryesore; numrin e studentëve të shkëlqyer; numrin e studentëve të çregjistruar ose të transferuar të shoqëruar me informacion mbi institucionin dhe programin e studimit të parë dhe programin e studimit ku transferohen; numrin e studentëve që kanë përfituar bursa dhe numrin e atyre që kanë përfituar nga përjashtimi apo reduktimi i tarifave të shkollimit; pjesëmarrjen e studentëve në projekte bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mbështetjen për lëvizshmërinë e tyre; përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen; një vlerësim të përgjithshëm mbi cilësinë e studentëve dhe vlerësimin e tyre për secilin cikël dhe program studimi;

<sup>4</sup> Shënim: Në këtë raport, në ndryshim nga procesi i akumulimit të të dhënave për Alumni, i cili realizohet për të dhënat e akumuluar për vitin akademik parardhës, në rastin e Kalendarit të Aktiviteteve, pasqyrohen aktivitetet e realizuara në vitin aktual kur hartohet ky raport.

Të dhëna statistikore për vitin akademik 2021-2022

Programet e studimit ofron IAL	Viti Akademik	Nr i studentëve të regjistruar për here të pare	Nr I Studenteve të transferuar	Nr I studenteve të larguar (sipas brezave)	Te Diplomuar (Sipas Brezave)
MSc në Arkitekture dhe Dizajn Urban	Viti akademik 2006-2007	41	1	9	32
	Viti akademik 2007-2008	80		16	63
	Viti akademik 2008-2009	57		13	39
	Viti akademik 2009-2010	61	6	17	45
	Viti akademik 2010-2011	46	4	13	30
	Viti akademik 2011-2012	56	5	15	38
	Viti akademik 2012-2013	35	3	15	20
	Viti Akademik 2013-2014	34	5	12	16
	Viti Akademik 2014-2015	25	3	5	17
	Viti Akademik 2015-2016	43	4	9	28
	Viti Akademik 2016-2017	62	3	19	37
	Viti Akademik 2017-2018	61	12	18	37
	Viti Akademik 2018-2019	72	27	34	7
	Viti Akademik 2019-2020	76	4	12	2
	Viti Akademik 2020-2021	99	3	10	1
	Viti Akademik 2021-2022	132	3	8	
BSc në Art Dizajn	Viti akademik 2010-2011	14			12
	Viti Akademik 2011-2012	22		2	15
	Viti Akademik 2012-2013	22	1	4	18
	Viti Akademik 2013-2014	31	1	9	24
	Viti Akademik 2014-2015	31	1	8	21
	Viti Akademik 2015-2016	43		7	28
	Viti Akademik 2016-2017	48	4	6	39
	Viti Akademik 2017-2018	50	2	12	33
	Viti Akademik 2018-2019	51	6	13	37
	Viti Akademik 2019-2020	70		10	40
	Viti Akademik 2020-2021	70		8	0
	Viti Akademik 2021-2022	82		1	0
MSc në Dizajn i Aplikuar	Viti akademik 2011-2012	6		1	5
	Viti akademik 2012-2013	5			4
	Viti akademik 2013-2014	7			6
	Viti akademik 2014-2015	6			4
	Viti Akademik 2015-2016	9		1	6
	Viti Akademik 2016-2017	6			2
	Viti Akademik 2017-2018	20			9
	Viti Akademik 2018-2019	16		1	9
	Viti Akademik 2019-2020	19		1	9

	Viti Akademik 2020-2021	16	1	1	10
	Viti Akademik 2021-2022	25			
Bsc në Inxhinieri Ndertimi	Viti akademik 2013-2014	16		4	8
	Viti akademik 2014-2015	15	1	5	11
	Viti Akademik 2015-2016	14	8	1	16
	Viti Akademik 2016-2017	13	7	10	8
	Viti Akademik 2017-2018	18	18	2	31
	Viti Akademik 2018-2019	16	6		15
	Viti Akademik 2019-2020	20	7	4	21
	Viti Akademik 2020-2021	24	4	1	15
	Viti Akademik 2021-2022	36	3	2	0
Msc në Inxhinieri Ndertimi	Viti Akademik 2016-2017	17			12
	Viti Akademik 2017-2018	32	7	1	30
	Viti Akademik 2018-2019	40	6	4	31
	Viti Akademik 2019-2020	20	1		16
	Viti Akademik 2020-2021	23			11
	Viti Akademik 2021-2022	26	1	2	0
Dizajn Arkitekturik dhe parametrik	Viti akademik 2011-2012	31		7	24
	Viti akademik 2012-2013	17		13	3
	Viti akademik 2013-2014	7			5
	Viti akademik 2014-2015	5			4
	Viti akademik 2015-2016	7		1	6
	Viti akademik 2016-2017	2			1
	Viti akademik 2017-2018	9			6
	Viti Akademik 2018-2019	12			6
	Viti Akademik 2019-2020	8		1	0
	Viti Akademik 2020-2021	13		2	2
MP Master Profesional I Avancuar në Arkitekturë Dixhitale	Viti Akademik 2021-2022	8			0
Dizajn Estetik Strukturor	Viti akademik 2011-2012	7		2	5
	Viti akademik 2012-2013	6		5	1
	Viti akademik 2013-2014	2			1
	Viti akademik 2014-2015	2			0
	Viti akademik 2015-2016	1			1
	Viti akademik 2016-2017	5			4
	Viti akademik 2017-2018	9			9
	Viti akademik 2018-2019	10	1	2	5
	Viti Akademik 2019-2020	18		1	0
Dizajn Urbani dhe Pejzazhi	Viti akademik 2011-2012	16		3	12

	Viti akademik 2012-2013	6		2	3
	Viti Akademik 2013-2014	4	1		4
	Viti Akademik 2014-2015	4			2
	Viti akademik 2015-2016	12		1	9
	Viti akademik 2016-2017	7			4
	Viti akademik 2017-2018	7		2	4
	Viti akademik 2018-2019	6	1	1	5
	Viti Akademik 2019-2020	5			3
MSc në Planifikim Urban	Viti akademik 2007-2008	18		3	15
	Viti akademik 2008-2009	12		3	8
	Viti akademik 2009-2010	20	1	4	16
	Viti akademik 2010-2011	13		1	10
	Viti akademik 2011-2012	17		2	15
	Viti akademik 2012-2013	32	2	5	19
	Viti Akademik 2013-2014	30		12	7
	Viti Akademik 2014-2015	16		2	9
	Viti Akademik 2015-2016	18	1	5	12
	Viti Akademik 2016-2017	21	2	5	12
	Viti Akademik 2017-2018	11		4	2
	Viti akademik 2018-2019	11		3	0
	Viti Akademik 2019-2020	9			0
	Viti Akademik 2020-2021	21	3	3	0
	Viti Akademik 2021-2022	18		5	0
BSc në Studime Mjedisore	Viti akademik 2011-2012	14		1	10
	Viti Akademik 2012-2013	20		3	13
	Viti Akademik 2013-2014	15	4	5	12
	Viti Akademik 2014-2015	25		2	19
	Viti Akademik 2015-2016	23		4	16
	Viti Akademik 2016-2017	11	3	2	7
	Viti Akademik 2017-2018	16	4	9	9
	Viti Akademik 2018-2019	10	4	1	9
	Viti Akademik 2019-2020	8	2		9
	Viti Akademik 2020-2021	24	3		3
	Viti Akademik 2021-2022	7		1	
MSc në MWU	Viti akademik 2011-2012	8			8
	Viti akademik 2012-2013	21		1	15
	Viti akademik 2013-2014	14		4	9
	Viti akademik 2014-2015	15			10

	Viti Akademik 2015-2016	30	3	1	26
	Viti Akademik 2016-2017	22	1	1	19
	Viti Akademik 2017-2018	21	2	1	20
	Viti Akademik 2018-2019	28	1	2	24
	Viti Akademik 2019-2020	18			15
	Viti Akademik 2020-2021	27			19
	Viti Akademik 2021-2022	13		2	0
MP MBA	Viti akademik 2014-2015	19			13
	Viti Akademik 2015-2016	25			22
	Viti Akademik 2016-2017	23		2	18
	Viti Akademik 2017-2018	25		1	14
	Viti Akademik 2018-2019	40		3	28
	Viti Akademik 2019-2020	22		3	11
	Viti Akademik 2020-2021	30		1	16
MSC MBA	Viti Akademik 2021-2022	4		1	
Planifikim Hapesinor & Aplikime GIS	Viti akademik 2011-2012	12		2	10
	Viti akademik 2012-2013	9	3	4	8
	Viti Akademik 2013-2014	10	1		10
	Viti Akademik 2014-2015	9	1		10
	Viti akademik 2015-2016	29		2	20
	Viti akademik 2016-2017	27		1	20
	Viti akademik 2017-2018	35	1		31
	Viti Akademik 2018-2019	20	2		16
	Viti Akademik 2019-2020	15	1		16
	Viti Akademik 2020-2021	25		1	17
	Viti Akademik 2021-2022	13			0
Strehim dhe zhvillim toke	Viti akademik 2011-2012	8			7
	Viti akademik 2012-2013	6		3	3
	Viti Akademik 2013-2014	6		1	2
	Viti Akademik 2014-2015	4			4
	Viti akademik 2015-2016	4		1	2
	Viti akademik 2016-2017	6		3	2
	Viti akademik 2017-2018	7		1	5
	Viti Akademik 2018-2019	5			4
	Viti Akademik 2019-2020	4			2
Zhvillim social urban dhe burime njerëzore	Viti akademik 2011-2012	9		3	6
	Viti akademik 2012-2013	9		4	4



	Viti Akademik 2013-2014	1			1
	Viti Akademik 2014-2015	5		1	4
	Viti akademik 2015-2016	8			6
	Viti akademik 2016-2017	7		1	5
	Viti akademik 2017-2018	10			8
	Viti Akademik 2018-2019	10		1	5
	Viti Akademik 2019-2020	4			4
Bsc Shkenca Komputeri ke	Viti Akademik 2019-2020	16	2		12
	Viti Akademik 2020-2021	34		1	0
	Viti Akademik 2021-2022	59	1	3	0
Shkollë profesionale Mirembajtje Rrjetesh Kompjuterik e	Viti Akademik 2019-2020	31		4	16
	Viti Akademik 2020-2021	29			16
	Viti Akademik 2021-2022	19			0
EFICENCE ENERGJITIKE	Viti akademik 2013-2014	14		5	8
	Viti akademik 2014-2015	25			19
	Viti Akademik 2015-2016	41		5	25
	Viti Akademik 2016-2017	63		2	47
	Viti Akademik 2017-2018	76		3	54
	Viti Akademik 2018-2019	31		1	18
	Viti Akademik 2019-2020	21		2	10
	Viti Akademik 2020-2021	22		1	14
Viti Akademik 2021-2022	7		1	0	
PHD	Viti akademik 2013-2014- Cikli 29	12			12
	Viti akademik 2014-2015- Cikli 30	13		1	12
	Viti Akademik 2015-2016- Cikli 31	6		2	4
	Viti Akademik 2016-2017- Cikli 32	10		2	8
	Viti Akademik 2017-2018- Cikli 33	13		1	11
	Viti Akademik 2018-2019- Cikli 34	11			2
	Viti Akademik 2019-2020- Cikli 35	12			
	Viti Akademik 2020-2021- Cikli 36	9			
	Viti Akademik 2021-2022- Cikli 37	13			

## Kreu A. 10. – Vlerësime dhe rekomandime për MAS

Universiteti POLIS vlerëson bashkëpunimin me MAS si shumë pozitiv. Sugjerimi ynë është që Ministria të ushtrojë maksimalisht rolin e vet rregullator dhe të garantojë konkurrencë të ndershme mes IAL-ve.

## PJESA B

### Kreu B.1. Struktura Organizative

*Të dhëna të përgjithshme mbi IAL-në lidhur me strukturën e përgjithshme organizative të institucionit të arsimit të lartë, njësitë përbërëse dhe autoritetet drejtuese përkatëse etj.*

POLIS ushtron veprimtarinë e tij nëpërmjet një sërë organesh, të tilla si njësitë akademike dhe kërkimore, njësitë administrative, por edhe kolegiale, të cilat veprojnë në përputhje me statutin,

rregulloren dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.

POLIS përfshin një strukturë të integruar e cila përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, të përmendura edhe në statut. Struktura organizative e Universitetit POLIS dallon 4 (katër) lloje të njësive organizative përbërëse:

1. Njësi kryesore që janë Fakultetet
2. Njësi bazë ku përfshihen departamentet dhe qendrat kërkimore;
3. Njësitë ndihmëse si laboratorë, studiot profesionale, etj;
4. Qendra ndër-departamentale për Studime Ndërdisciplinore Kërkimore dhe Inovacioni.

Siç shihet nga skema organizative e institucionit (*Aneks 9 – Struktura Organizative*), POLIS përbëhet nga 3 njësi kryesore dhe 9 njësi bazë (3 për secilën njësi kryesore), nga të cilat 6 departamente me natyrë akademike dhe 3 njësi të dedikuara tërësisht për kërkim.

Në përputhje me misionin dhe objektivat e veta, POLIS ka krijuar gjithashtu një qendër kërkimore ndërdisiplinare, përkatësisht Fabrika e Inovacionit (IF), e cila koordinon përpjekjet dhe nismat ndërmjet të gjitha njësive që lidhen me konceptet, teoritë, qasjet, metodologjitë, praktikat e zhvilluara në POLIS. Përveç kësaj, POLIS ka themeluar një numër organesh të pavarura (organe kolegjinale) që sigurojnë mirë funksionimin e institucionit. Organe të tilla kanë një fushë të qartë dhe përgjegjësi dhe janë përgjegjëse për aspekte të ndryshme të jetës akademike. Mund të përmendim Këshillin e Etikës, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e Këshillimit për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.

Secili organ kolegjal ushtron funksionin e tij sipas rregullores së vet dhe sipas kompetencave të parashikuara në Statutin e institucionit.

## Kreu B.2. Raporti financiar

*Të dhëna për planin buxhetor afatmesëm, planin buxhetor njëvjeçar dhe planin strategjik të zhvillimit të institucionit. Realizimin faktik të planit buxhetor të vitit paraardhës buxhetor sipas zërave të buxhetit, planin buxhetor të vitit pasardhës akademik, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik në vijim. Dokumentacionin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore;*

	<b>Realizimi faktik i buxhetit të vitit 2021-2022</b>	<b>ne 000 leke</b>
<b>Nr</b>	<b>Te ardhurat</b>	<b>Vlera</b>
1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	277,000
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	23,000
3	Te ardhura të tjera	11,000
	<b>Total</b>	<b>311,000</b>
<b>Nr</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Vlera</b>
1	Paga staf i brendshëm dhe i ftuar	200,000
2	Shpenzime administrimi	79,000
3	Investime	31,000
	<b>Total</b>	<b>310,000</b>

### **Plani i buxhetit të vitit akademik 2022-2023 ne 000 leke**

<b>Nr</b>	<b>Te ardhurat</b>	<b>Vlera</b>
-----------	--------------------	--------------

1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	308,000
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	14,000
3	Te ardhura te tjera	12,000
	<b>Total</b>	<b>334,000</b>

<b>Nr</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Vlera</b>
1	Paga staf i brendshem dhe i ftuar	240,000
2	Shpenzime administrimi	75,000
3	Investime	10,000
	<b>Total</b>	<b>325,000</b>

#### Plani buxhetor afatmesëm 2022-2025

Nr	Te ardhurat	Vlera 2022-2023	Vlera 2023-2024	Vlera 2024 -2025
1	Te ardhurat nga tarifat e shkollimit	308,000	340,000	370,000
2	Te ardhura nga projekte dhe grante	14,000	18,000	22,000
3	Te ardhura te tjera	12,000	15,000	18,000
	<b>Total</b>	<b>334,000</b>	<b>373,000</b>	<b>410,000</b>

Nr	Shpenzimet	Vlera	Vlera	Vlera
1	Paga staf i brendshem dhe i ftuar	240,000	270,000	290,000
2	Shpenzime administrimi	75,000	78,000	85,000
3	Investime	10,000	12,000	15,000
	<b>Total</b>	<b>325,000</b>	<b>360,000</b>	<b>390,000</b>

Bashkëlidhur raportit përkatësisht në *(Aneks 10 - Vërtetim shlyerje detyrime 2021- 2022)*.

### Kreu B.3. Mobiliteti i personelit akademik

*Të dhëna mbi mobilitetin e personelit akademik të financuara nga IAL-ja apo të realizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare.*

Në përputhje me Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të Universitetit POLIS dhe në përputhje me moton e institucionit si një hapësirë e lirë e mendimit, një rëndësi e veçantë gjatë vitit akademik 2021-2022 i është kushtuar mobilitetit të stafit akademik. Qëllimi kryesor i mobiliteteve është shkëmbimi i eksperiencave, transferimi i dijeve dhe rritja profesionale e stafit.

Më konkretisht gjatë vitit akademik 2021-2022, në kuadër të projekteve Erasmus+KA1 të mobilitetit kanë qënë pjesë e këtij programi 16 pjesëtarë të staf akademik, gjatë semestrit të parë dhe të dytë.

Krahas këtij shkëmbimi eksperiencash apo mundësie trajnimi nëpërmjet programit Erasmus + KA1, Universiteti POLIS vazhdon të jetë pjesëmarrës aktiv edhe në programet Erasmus+ KA2 "Ngritja e Kapaciteve në Arsimin e Lartë". Një prej moduleve të këtij programi i kushtohet pikërisht shkëmbimit aftashkurtë të stafit mes vendeve partnere dhe vendeve evropiane, si pjesë e trajnimit apo transferimit të dijeve.

Tabela 1. Të dhëna për mobilitetin e stafit (KA1)

University	Incoming	Outgoing
<b>University of Minho, Portugal</b>	1	2
<b>Politecnico di Bari</b>	5	4
<b>University of Molise</b>	4	2
<b>The Royal Academy of Art in Hague</b>	2	3
<b>Riga Building College Latvia</b>	-	3
<b>Anhalt University</b>	-	2

### Mobiliteti i studentëve

Dhënia e mundësisë që studentët të jenë pjesë e mobiliteteve dhe të realizojnë një periudhë studimi (një semestër) në universitetet evropiane, është një tjetër prioritet i Universitetit POLIS. Ndonëse Shqipëria është pjesë e kësaj skeme vetëm 3 vitet e fundit, shifrat e mobilitetit të studentëve flasin për një zhvillim në fritje.

Në Universitetin e Minho-s ka zhvilluar mobilitet 1 student i programit të doktoraturës, ndërsa në Universitetin e Anhalt në Gjermani kanë studiuar gjatë vitit akademik 2021-2022, 11 studentë të Universitetit POLIS, në kuadër të Erasmus+ KA1. Tre studentë të tjerë kanë zhvilluar mobilitet në Universitetin FH Joanneum, etj (shiko tabelen më poshtë).

Tabela 2. Të dhëna për mobilitetin e studentëve

University	Outgoing students
<b>University of Minho, Portugal</b>	1
<b>University of Anhalt</b>	11
<b>FH Joanneum</b>	3
<b>Politecnico di Bari</b>	3
<b>University of Napoli</b>	1
<b>University of Molise</b>	6
<b>University of West Attica</b>	3
<b>University IGS Paris</b>	1
<b>Ecole University in Paris</b>	1
<b>University of Cordoba</b>	1

### B.4. Konformiteti me Kodin e Cilësisë

Të dhëna për plotësimin e standarteve shtetërore akademike dhe infrastrukturore, në përputhje me Kodin e Cilësisë, ku përfshihen ndryshime në mjedise didaktike, kërkimore, numri i teksteve dhe infrastruktura informatike në funksion të mësimin.

Sigurimi i cilësisë ka qenë një aspekt i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit që prej themelimit të tij. POLIS synon të krijojë një kulturë të fortë mes komunitetit të tij, prandaj njësia e krijuar NJBSC, ka mbështetje të fortë dhe i është dhënë autonomi e plotë.

Njësia e ka zgjeruar vazhdimisht fushën e saj të veprimit dhe aktualisht mbulon jo vetëm procesin e mësimdhënies, por edhe funksionet kërkimore dhe administrative. POLIS ka marrë vazhdimisht reagim pozitiv nga kontrole të ndryshme të cilësisë dhe procese akreditimi në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare, por të qenit autokritik është një parim thelbësor në përjasjen institucionale, ndaj rekomandimet e NJBSC janë një informacion i vyer për rishikimin e organizimit të strukturës institucionale apo programeve akademike me qëllimin

final arritjen e objektivit të POLIS: të sigurojë ekselencë në mësimdhënie dhe të plotësojë standardet më të larta akademike.

Kjo vëmendje e posaçme ndaj cilësisë është reflektuar dhe në korrektesën maksimale të institucionit ndaj të gjitha proceseve të vlerësimit të cilësisë, jo vetëm atij të brendshëm por dhe akreditimeve institucionale dhe programore konform afateve të parashikuara në ligj.

POLIS i është nënshtruar 3 herë akreditimit institucional (2 prej të cilave me ekspertë të huaj), ka akredituar të gjitha programet e studimit (disa prej tyre dhe ri-akredituar), disa programe (MSc në Planifikim dhe Menaxhim Urban dhe PhD në Arkitekturë dhe Planifikim Urban) kanë kryer akreditim ndërkombëtar, është pajisur me certifikatë ISO për sistemin e menaxhimit dhe aktualisht është në process të akreditimit të laboratorit të mjedisit.

Për sa i përket teksteve mësimore dhe mënyrën se si studentëve u ofrohet ky shërbim, shiko rreth Biblo\_POLIS, në linkun [https://www.universitetipolis.edu.al/biblo\\_polis/](https://www.universitetipolis.edu.al/biblo_polis/)

Garantimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm dhe për POLIS mbetet një objektiv që cilësinë ta kthejë në kulturë institucionale.

Kodi i Cilësisë në zbatim të Ligjit 80/2015 është miratuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021 mbi "Miratimin e Kodit të Cilësisë për Arsimin e Lartë" dhe U\_POLIS vijon aktivitetin në përputhje me parashikimet e këtij Kodi.



## ANEKSE

- Aneks 1 – Strategjia e zhvillimi
- Aneks 2 – Udhëzues, Masat COVID-19
- Aneks 3 – Raport, Veprimtaria Kërkimore Shkencore
- Aneks 4 - Broshura e Bibliotekës
- Aneks 5 - Formularët për çdo proces vlerësimi NJBSC
- Aneks 6 - Planet Mësimore 2021-2022
- Aneks 7 - Pyetësor Alumni
- Aneks 8 – Kalendar i aktiviteteve 2021-2022
- Aneks 9 - Struktura organizative
- Aneks 10- Vërtetim shlyerja e detyrimeve 2021-2022
- Aneks 11 – Formulari klubeve studentore
- Aneks 12 – Kalendar i miratuar